

BASHKIA TIRANË

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Tiranë
Adresa Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
E-mail administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit www.tirana.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Marisa Kaçori
E-mail administrative.prokurime@tirana.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Proçedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: Shërbim

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-50064-11-15-2022.

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut”.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45316210-0 Instalime të pajisjeve që monitorojnë trafikun; 32412100-5 Rrjeti i telekomunikacionit; 71322500-6 Shërbime për projektme teknike të infrastruktures së trafikut.

8. Fondi limit: 81.040.227 (tetëdhjetë e një milion e dyzetë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr.166, datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022” i rialokuar në V.K.B Nr. 125 dt 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Modifikimi kryhet në përputhje me nenin 127 pika 1 gërma (c) të ligjit nr 162//2020 për “Prokurimin Publik” dhe nuk ndodhet në kushtet e nenit 127 pika 4 e ligjit Nr.162/2020 për “Prokurimin Publik” pasi nuk kemi të bëjmë me modifikim të një kushti thelbësor të kontratës. Në datë 08.02.2024 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është paraqitur shkresa me Nr. 6022/1 prot nga Drejtoria e Përgjithshme e Investimeve të Punëve Publike, Drejtoria e Transportit të Trafikut Rrugor me anë të së cilës kërkohet “Shtyrja e afatit të përfundimit të shërbimit në objektin: “Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut”. Nga ana e mbikqyrësit të punimeve, shoqëria “Palma Construction” shpk

me shkresën e datës 06.02.2024 me nr. Prot hyrës në Bashkinë e Tiranës 6022 prot dhe sipërmarrësit shoqëria “Communication Progress” shpk me shkresën hyrëse me Nr. 6023 prot dt 07.02.2024 kërkohet shtyrja e afatit të kontratës me objekt: “Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut” për arsytet si më poshtë vijon:

Gjatë procesit të implementimit për centralizimin e nyjeve semaforike disa prej kartave SPOT të sinjalizimit dhe komunikimit me platformën qendrore të cilat janë vendosur në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, kanë rezultuar me difekte teknike. Kjo ka sjellë vonesa në implementimin e projektit për disa nyje semaforike. Së fundmi, nga ana e Autoritetit Kontraktor na janë vendosur në dispozicion disa karta të tjera SPOT të cilat fillimisht nevojiten të konfigurohen. Për këtë arsye nevojiten të bëhen modifikime në përshtatshmërinë dhe konfigurimin e tyre gjë për të cilin kontraktori është duke punuar në mënyrë intensive për të arritur rezultatet e pritshme. Nga ana e kontraktorit për të konkluduar me përfundimin e shërbimit nevojitet zgjatja e kontratës për 3 (tre) muaj kalendarikë.

Grupi i punës i cili menaxhon edhe ndjek kontratën Nr.1065/5 prot, datë 13.02.2023. me objekt:“Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut”, ka gjykuar mbështetur në relacionin teknik të mbikqyresit, që afati i shtyrjes së kontratës do të jetë 3 (tre) muaj kalendarikë me përfundim data 12.05.2024, kohë kjo e mjaftueshme për përmbushjen e të gjitha detyrave për realizimin e planit

Referuar sa më sipër, si dhe bazuar në Nenin 1 dhe Nenin 10, të kontratës Nr.2910 prot, datë 20.01.2023, me objekt: “Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut”, Drejtoria e Përgjithshme e Investimeve të Punëve Publike, me memon Nr.6022/1 prot, datë 08.02.2024, sugjeron shtyrjen e afatit të kontratës deri në datë 12.05.2024.Referuar sa më sipër cituar u konkludua në lidhjen aktmarrëveshjes midis palëve respektive të cilat dakortësuan shtyrjen e afatit të kontratës sikundër cituar më sipër.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:Do të ketë vetëm shtyrje të afatit të kontratës me Nr.1065/5 prot, datë 13.02.2023 pa asnjë ndryshim tjetër përsa i përket natyrës, sasive apo vlerës së shërbimit.

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: Nuk ndryshon vlera me të cilën është lidhur kontrata.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):Nuk është rasti.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Afati i kryerjes së shërbimit 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati i ri i vendosur bazuar në lidhjen e Aktmarrëveshjes për realizimin e shërbimit do të jetë duke nisur nga data 12.02.2024 deri në dt. 12.05.2024.

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK

Adresa: Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7

NUIS: K01625001C.

Telefoni: 0682058221

Numri i faksit:

E-mail: cp@commprog.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 12.02.2024